

FJALA E DEPUTETIT SALI BERISHA

E ENJTE 8 SHTATOR 2022

Të dashura qytetare dhe qytetarë shqiptarë,

Zonja dhe zotërinj deputetë,

Sot ne mbliidhemi këtu për një akt fasadë, aktin fasadë të radhës, në aparençë për një akt që synon të rregullojë vendosjen e flamurit europian krahas flamurit tonë apo flamujve të tjerë, por de facto ne vijmë këtu si kombi, si vendi, si populli i ëndrrave të grabitura, i ëndrrave të rrënuara. Që nga mesi i viteve '800 dhe gjer sot, ëndrra e shqiptarëve ishte ëndrra europiane. Ajo u formua me gjak. E vërteta, para se të shkruhej në libra, u formua me një qëndresë ndaj të tjerëve që parashikonin të na konvertonin totalisht në otomanë, për të mos thënë edhe të na shfarosnin nga trojet tona. Por në këtë proces të ëndrrës së grabitur, ëndrrës së vjedhur, një rol shpeshherë më të ligë sesa vetë pushtuesit kanë luajtur shqiptarët.

Një përpjekje prej dy dekadash e Ahmet Zogut për ta shkëputur Shqipërinë nga otomanizmi pesëshekullor që trashëgoi dhe për ta renditur atë me vendet e Europës u ndërpre nga një diktaturë, nga një tradhti kombëtare, e cila jo vetëm la Kosovën nën sundimin e Jugosllavisë dhe të Serbisë, por bëri gjithçka që edhe Shqipërinë ta shndërrojë në republikë të ish-Jugosllavisë. Në këto 46 vjet të diktaturës staliniste, Enver Hoxha, për karrigen e tij e shkëputi Shqipërinë si asnjë vend tjetër në Europë nga qytetërimi dhe rrjedhja europiane. Edhe vende të tjera ishin diktatura komuniste, por nuk qenë izoluese në atë shkallë të tmerrshme sa ishte diktatura staliniste e Tiranës. Në fakt, ato ishin vitet e burgut më të gjatë të ëndrrës europiane të shqiptarëve.

Lëvizja studentore shënoi një akt madhor në historinë tonë kombëtare dhe, krahas përmbysjes së diktaturës në rrafshin kombëtar, ajo lëvizje u dha fund tentakulave të Beogradit në Tiranë. Dhe kjo ishte një arritje madhore historike për shqiptarët. Në këtë udhëtim drejt Europës, sigurisht që ne do të kishim vështirësitë më të mëdha, por në mënyrë të pamohueshme ai u

dëshmuar një udhëtim i pandalshëm. Ëndrra europiane e shqiptarëve, ëndrra euratlantike e tyre u konkretizua me anëtarësimin e Shqipërisë në NATO, u konkretizua me një seri aktesh, marrëveshesh historike me Bashkimin Europian.

Sot ne votojmë në njëfarë aspekti për flamurin europian dhe kjo është shumë normale, por problemi është se kjo qeveri dhe kreu i saj për flamur të vërtetë ka atë të Beogradit; për kryeqytet të vërtetë europian nuk ka Brukselin, për kryeqytet të vërtetë ka Beogradin. Në mënyrë të befasishme, në vitin 2013, Edi Rama, sikur të zgjohej nga varri Enver Hoxha, vrapoi me padurim drejt Beogradit. Mirëpo në vitet 2010-2013 pati një proces intensiv negociatash ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit si palë të barabarta. Edi Rama u vu në shërbim të padronit të tij dhe bëri gjithçka për ta bllokuar atë proces, i cili eci deri në nënshkrimin e marrëveshjes së përgjithshme, marrëveshje e cila, de facto, absolutisht sanksiononte njohjen reciproke të të dyja vendeve njëri me tjetrin.

Nuk mohoj këtu se një faktor tejet i rëndësishëm në arritjen e saj ishte qëndrimi i Shqipërisë. Në se konsistonte ky qëndrim? Në refuzimin kategorik të saj për të ndërhyrë në procesin e negociatave. Sado që në pamje të parë mund të dukej i habitshëm, në të vërtetë ai ishte pozicioni që forconte më shumë se çdo pozicion tjetër përfaqësimin e Kosovës nga qeveria e saj. Edi Rama, me shpejtësi, në udhëtimin e tij në Beograd, e përmbysi këtë raport. Ndërmori përçarjen e klasës politike në mbështetje të projekteve të Xhorxh Sorosit, të shkëmbimit të territoreve dhe të ndryshimit të kufijve, de facto, të copëtimit dhe zhbërjes së Kosovës së pavarur. Shqipëria, në vend që t'i përqendronte të gjitha energjitë e saj drejt Brukselit, e përqendroi të gjithë potencialin e qeverisjes së saj drejt Beogradit.

Edi Rama, pasi dështoi me projektin e ndryshimit të kufijve, si vasal i Vuçiçit, ndërmori projektin e Ballkanit të Hapur. Të dashura qytetare dhe qytetarë, mos harroni se, pas asaj firme tradhtare të aleancës trilaterale Beograd-Shkup-Prishtinë, të cilën Vuçiçi do ta quante krijimi i Jugosllavisë së vjetër plus Shqipërinë, padroni i Edi Ramës bashkë me vasalin e tij vendosën para platformës nga e cila flisnin hartën e Ballkanit, ku Kosova ishte fshirë prej saj dhe paraqitej si pjesë e Serbisë. Të njëjtën hartë Edi Rama e publikoi në facebook-un e tij. Shëtiti me hartat si një shtrig

i vërtetë, si një Makbeth i çështjes kombëtare, në kancelaritë europiane. Krahas kësaj, i kundërvuri Ballkanin e Hapur Projektit të Berlinit.

Shqiptarët do t'i jenë mirënjohës përjetë Angela Merkelit për dy arsye: E para, ajo krijoi Procesin e Berlinit, i cili mbajti gjallë për rajonin tonë frymën e integritit europian, sepse rrezikonim shumë të kalonim në zonë partnere. E dyta, hodhi në kosh çdo hartë të copëtimit dhe ndryshimit të kufijve. Pra, ëndrra jonë europiane udhëtoi drejt Beogradit, për të mos thënë se kjo ëndërr u shua në Shqipëri me zëvendësimin e shtetit ligjor me narkoshtetin e parë në Europë, me zhdukjen e sigurisë ligjore, me vendosjen e bandave në të gjitha nivelet, me lidhjet e tmerrshme të Edi Ramës me krimin, me shndërrimin e Shqipërisë në një mollë të ndaluar për kompanitë europiane dhe garën, me shndërrimin e shqiptarëve në emigrantë, të cilët largohen nga vendi i tyre më shumë se çdo qytetar tjetër i Europës.